



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Departamenti i Industrisë - Divizioni për Politika Industriale

SEKTORI C

Industria Përpunuese



INFORMALITETI NË PUNËSIM



Përmbajtja

Shkurtesat	2
Lista e tabelave.....	3
Hyrje.....	4
Metodologjia.....	5
Arsyejet e punësimit informal.....	6
Ndërmarrjet sipas nën sektorëve në regjione.....	7
Numri i të punësuarve sipas nën sektorëve.....	9
Numri i të punësuarve sipas nën sektorëve sipas anketës së fuqisë puntore.....	10
Informaliteti i punësimit në sektorin C.....	12
Konkluzionet.....	14

Shkurtesat

- ATK - Administrata Tatimore e Kosovës
ASK - Agjencia e Statistikave të Kosovës
MINT - Ministria e Industrisë, Ndërmarrsisë dhe Tregtisë
ILO - Organizata Ndërkombëtare e Punës

Lista e tabelave

Tabela 1 -	Përqindja e ndërmarrjeve sipas nën sektorëve në regjione 2021.....	8
Tabela 2 -	Të punësuarit sipas nën sektorëve, të dhënave të punëtorëve të regjistruar.....	10
Tabela 3 -	Të punësuarit sipas nën sektorëve, të dhënat e anketës së fuqisë puntore.....	11
Tabela 4 -	Identifikimi i nënsektorëve me informalitet më të lartë.....	13

Hyrje

Informaliteti në punësim është i shprehur në gjithë botën, ekonomia joformale zakonisht më shumë është e shprehur te vendet me papunësi më të lartë dhe me të ardhura të ulëta.

Sipas definimeve të ndryshme një vend pune joformal është një vend pa marrëveshje zyrtare pune midis punëdhënësve dhe punonjësve.

Problemi i informalitetit të të punësuarit, përpos që ka ndikim negativ në buxhetin e shtetit më shqetësuese është me që të punësuarit joformal nuk kanë mundësi të kenë qasje nga përfitimet që lidhen me formalitetin, nuk mundë të dëshmojnë përvojën e punës, nuk kanë qasje në pushimet vjetore, mjekësore, nuk kanë mundësi as të ankohen për ndërprerje të marrëdhënies së punës etj.

Punësimi joformal, që është puna pa kontratë, mbrojtje ligjore ose sigurime shëndetësore, është marrëveshje më e zakonshme e punësimit në botë. Sipas ILO-s, pjesa e saj në punësimin total (treguesi i SDG 8.3.1) ishte 61% (2 miliardë punëtorë) deri në vitin 2016. Në fakt punësimi joformal përbën një shtyllë strukturore të vazhdueshme të tregjeve të punës, veçanërisht në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme. Në SHBA dhe BE, punësimi joformal është rreth 18% dhe 15% e fuqisë punëtore të punësuar, në Amerikën Latine shkon në 53% dhe 88%, në Afrikë dhe Azi (me përjashtim të Kinës) 77%.¹

Ky raport identifikon nivelin e punësimit informal të sektorit C (Industrië përpunuese), në Kosovë, me qëllim të krijimit të një ambienti të mirë për të bërë biznes, duke nxitur punësim të qëndrueshëm në këtë sektorë dhe duke ndihmuar institucionet tjera për të zbatuar dokumentet e tyre strategjike si “Strategjisë kombëtare të republikës së Kosovës për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë jo-formale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare 2019-2023” etj.

¹ Scand of Work Environ Health 2022;48(3):169-172, <https://doi.org/10.5271/sjweh.4024>

Metodologjia

Metodologjia për hartimin e këtij raporti mbështetet mbi të dhënat sasiore dhe cilësore të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, si dhe dokumentet tjera për ekonominë informale.

Të dhënat janë analizuar me fokus në sektorin e Industrisë përpunuese (Sektori C), për përgatitjen e analizës për të vlerësuar shkallën e informalitetit në punësim sipas aktiviteteve të industrisë përgjatë periudhës 2017 -2021.

Këto të dhëna, janë përpunuar dhe analizuar nga stafi i MINTI-it, konkretisht nga përpunuesit e statistikave dhe hartuesit e Politikave Industriale në Departamentin e Industrisë / Divizioni për Politika industriale.

Për të gjitha të dhënat që janë përdorur në këtë raport, janë shënuar thirrjet apo burimi i informatave.

Arsyeja e punësimit joformal

Informaliteti është një sfidë komplekse, me shtytës të shumtë dhe variacione të bazuara në rrethanat kombëtare. Në literaturën akademike, ekzistojnë dy shkolla kryesore të menduar për shkaqet e informalitetit. Të dyja shkollat e mendimit ofrojnë njohuri të rëndësishme. Informaliteti është një kompleks dhe fenomen i shumë anshëm, jo i tillë që mund t'i atribuohet një shkaku të vetëm.²

Sipas autorëve të ndryshëm, arsyeja kryesore të informalitetit në biznes janë te ndërmarrjet mikro dhe të vogla, kryesisht në vendet në zhvillim, për arsyeje se pjesa e punësimit është e përqendruar në prodhimin parësor, duke përdorur metodat tradicionale dhe aktivitetet kryhen kryesisht nga vet pronarët.

Sektori i industrisë prodhuese në Kosovë, ka një strukturë më të organizuar krahasuar me sektorët tjerë dhe se informaliteti te ky nën sektor është më i ulët krahasuar me sektorët si bujqësia dhe ndërtimtaria.

Arsyejet e punësimit joformal janë të natyrave të ndryshme, me gjithat bazuar në diskutimet me bizneset e sektorit prodhues ndër arsyejet kryesore është punësimi me kohë të shkurtër ku nuk mundë të gjenden punëtor të kualifikuar, kjo ndërlidhet edhe me raportin e Bankës Botërore “Diagnoza e vendeve të punës në Kosovë”, ku specifikohet se Arsimi i papërshtatshëm është një kufizim më i madh për firmat më të mëdha. Mes firmave të vogla (5-19 punëtorë), 19 përqind e identifikuan arsimin si kufizim kryesor, ndërsa në ato me madhësi të mesme (20-99 të punësuar) kjo u rrit në 32 përqind, dhe mes firmave të mëdha (100+) të punësuar 43 përqind e panë atë si kufizim.

Një ndër çështjet që mundë të ndikoj në informalitet dhe që kanë gjasat më të ulëta të kenë një marrëveshje formale pune është edhe punësimi i paqëndrueshëm, ku sipas Anketës së Fuqisë Punëtoze TM1 2022, 11.6 % e personave të punësuar punonin në vende pune të paqëndrueshme. Punëtorët në punë të paqëndrueshme janë ose persona të vetëpunësuar pa punonjës, ose ata që punojnë pa pagesë në një biznes familjar. Të punësuarit në fusha profesionale dhe personat me nivel të lartë të arsimit kanë më pak gjasa të jenë të punësuar në punë të paqëndrueshme.

² The Informal Economy: an Employer's Approach, <https://www.ioe-emp.org/index.php?elD=dumpFile&t=f&f=155931&token=27b9b511c79c9bd920ca46fb21517f9074209889>

Ndërmarrjet sipas nën sektorëve në regjione

Analiza sektoriale në këtë raport përfshinë industrinë përpunuese, sipas NACE Rev2, nën sektorët e radhitur sipas kodeve, 10 deri në 33, në kuadër të Sektorit-C. Në këtë pjesë të raportit janë analizuar të dhënat që kanë të bëjnë me ndërmarrjet.

Nga të dhënat e paraqitura vërehet se sektori C ka 5,984 ndërmarrje, në totalin e ndërmarrjeve sektori C merr pjesë rreth 13.5%.

Tabela 1. Përqindja e ndërmarrjeve sipas nën sektorëve në regjione 2021

Kodi	Sektori-C	Prishtinë	Prizren	Ferizaj	Pejë	Gjilan	Mitrovicë	Gjakovë
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	29.75	20.73	10.60	9.99	7.73	8.69	12.52
11	Prodhimi i pijeve	13.73	11.76	9.80	15.69	14.71	2.94	31.37
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	28.57	14.29	0.00	14.29	14.29	0.00	28.57
13	Prodhimi i tekstilit	30.64	13.29	18.50	6.94	9.83	6.94	13.87
14	Prodhimi i veshjeve	25.43	18.29	10.00	6.00	10.86	7.14	22.29
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurë	28.21	33.33	10.26	12.82	2.56	7.69	5.13
16	Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës	19.77	12.67	13.44	14.97	13.82	10.17	15.16
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës	40.20	20.59	16.67	7.84	4.90	1.96	7.84
18	Shtypja dhe riprodhimi i mediave të incizuara	51.67	10.56	6.67	7.78	5.56	6.11	11.67
19	Prodhimi i Koksit dhe produkteve të rafinuara të naftës	25.00	12.50	37.50	12.50	0.00	12.50	0.00
20	Prodhimi i produkteve kimike	38.89	13.49	13.49	6.35	10.32	7.94	9.52
21	Prodhimi i produkteve bazë farmaceutike dhe preparateve farmaceutike	100.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
22	Prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës	27.46	17.62	13.64	7.94	13.64	7.77	11.92
23	Prodhimi i produkteve minerale jometalike	23.12	19.45	14.86	11.38	9.91	7.71	13.58
24	Prodhimi i Metaleve	28.91	17.19	16.41	7.03	8.59	6.25	15.63

25	Prodhimi i produkteve të fabrikuar metalike	25.71	14.81	15.84	11.82	12.08	7.01	12.73
26	Prodhimi i kompjuterëve, produkteve elektronike dhe optike	60.71	21.43	3.57	3.57	3.57	7.14	0.00
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	34.09	18.18	15.91	2.27	4.55	4.55	20.45
28	Prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t.	31.58	18.42	13.16	7.89	13.16	2.63	13.16
29	Prodhimi i mjeteve motorike, rimorkio dhe gjysmërimorkio	33.33	16.67	16.67	16.67	0.00	16.67	0.00
30	Prodhimi i mjeteve tjera të transportit	33.33	11.11	0.00	0.00	22.22	11.11	22.22
31	Prodhimi i mobileve	20.95	9.47	38.98	8.01	8.93	8.20	5.46
32	Prodhimi tjetër p.k.t.	33.96	9.43	14.15	21.70	5.66	3.77	11.32
33	Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve	41.51	8.49	16.04	7.55	7.55	11.32	7.55

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Me përqindjen më të lartë të ndërmarrjeve në Sektorin C, prinë regjioni i Prishtinës me 27.77%, pastaj radhitet regjioni i Prizrenit me 16.34%, regjioni i Ferizajt me 15.34%, regjioni i Gjakovës me 12.83%, regjioni i Pejës me 10.01%, regjioni i Gjilanit me 9.94% dhe regjioni i Mitrovicës me 7.75% të ndërmarrjeve në sektorin C.

Sa i përket nën sektorëve, numri me i madh i ndërmarrjeve është në nën sektorin e “Përpunimi i produkteve ushqimore” me 1462 ndërmarrje apo 24.4%, pasuar nga nën sektori “Prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës” me 579 ndërmarrje apo 9.7%, vendin e tretë radhitet nën sektori “Prodhimi i mobileve” me 549 ndërmarrje apo 9%, vendin e katër zë “Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës” me 521 apo 8.7%.

Nën sektori i prodhimit të pijeve me përqindje më të lartë është i përqendruar në regjionin e Gjakovës, nën sektori i prodhimit të lëkurës dhe produkteve prej lëkurë është i përqendruar kryesisht në regjionin e Prizrenit, Prodhimi i Koksit dhe produkteve të rafinuara të naftës dhe nën sektori i prodhimit të mobileve është i përqendruar në regjionin e Ferizajt, ndërsa nën sektorët tjerë me përqindje më të lartë janë të shpërndarë në regjionin e Prishtinës.

Numri i të punësuarve sipas nën sektorëve

Të dhënat krahasuese në tabelën nr. xx tregojnë se, gjatë pese viteve të fundit, është shënuar rritje në punësim, ne vitin 2021 ka shënuar rritje për 14%, krahasuar me vitin 2020.

Sektori C- Industria përpunuese, në normën e punësimit sipas aktivitetit ekonomik merr pjesë me 11.8%.³

Tabela 2. Të punësuarit sipas nën sektorëve, të dhënave të punëtorëve të regjistruar

Kodi	Industria Përpunuese	Numri i të punësuarve				
	Sektori-C	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	5,622	6,153	6,725	8,081	9,902
11	Prodhimi i pijeve	1,685	1,822	1,823	2,138	2,221
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	80	25	44	26	74
13	Prodhimi i tekstit	835	817	629	802	809
14	Prodhimi i veshjeve	746	857	856	1,151	1,610
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	428	430	379	420	406
16	Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës	1,212	1,390	1,429	1,766	2,389
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës	450	430	463	720	646
18	Shtypja dhe riprodhimi i mediave të incizuara	580	586	709	785	962
19	Prodhimi i Koksit dhe produkteve të rafinuara të naftës	49	62	109	116	179
20	Prodhimi i produkteve kimike	561	642	624	762	946
21	Prodhimi i produkteve bazë farmaceutike dhe preparateve farmaceutike	219	94	89	103	118
22	Prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës	2,270	2,374	2,793	3,513	3,661
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	3,588	3,796	4,454	5,082	5,469
24	Prodhimi i Metaleve	1,039	1,051	1,110	1,280	794
25	Prodhimi i produkteve të fabrikuara metalike	2,236	2,471	2,494	3,112	3,065
26	Prodhimi i kompjuterëve, produkteve elektronike dhe optike	48	54	48	71	80
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	189	228	215	224	261
28	Prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t.	104	122	131	174	274
29	Prodhimi i mjeteve motorike, rimorkio dhe gjysmë rimorkio	31	36	47	53	111

³ Agjencia e Statistikave të Kosovës / Vjetari Statistikor, 2022.

30	Prodhimi i mjeteve tjera të transportit	49	43	44	54	55
31	Prodhimi i mobileve	1,862	2,314	2,608	3,833	4,915
32	Prodhimi tjetër p.k.t.	172	219	266	281	430
33	Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve	62	82	89	144	181
	Gjithsej	24,117	26,098	28,179	34,691	39,558

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Sa i përket nën sektorëve, numri me i madh i të punësuarve në pese vitet e fundit prin nën sektorin e “Përpunimi i produkteve ushqimore” ku në vitin 2021 ka 9,902 të punësuar apo 25%.

Nën sektori “Prodhimi i produkteve minerale jo metalike” ka 5,469 të punësuar apo 14%, vendin e tretë radhitet nën sektori “Prodhimi i mobileve” me 4,915 të punësuar apo 12%, vendin e katër zë “Prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës” me 3,661 të punësuar apo 9%.

Numri i të punësuarve sipas nën sektorëve sipas anketës së fuqisë punëtore

Të dhënat krahasuese në tabelën nr. 3, tregojnë se ndër vite, është shënuar rënie në punësim, në vitin 2021 ka shënuar rënie për -3.5%, krahasuar me vitin 2020.

Sektori C- Industria përpunuese, në normën e punësimit sipas aktivitetit ekonomik merr pjesë me 12%.

Tabela 3. Të punësuarit sipas nën sektorëve, të dhënave e anketës së fuqisë punëtore

Kodi	Industria Përpunuese	Numri i të punësuarve				
	Sektori-C	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	11,497	7,455	7,146	7,677	8,017
11	Prodhimi i pijeve	1,002	926	1,927	2,374	1,702
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	97	60	-	17	-
13	Prodhimi i tekstilit	1,079	998	2,065	1,937	1,089
14	Prodhimi i veshjeve	1,434	935	768	1,510	2,215
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	530	648	855	633	612
16	Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës	2,969	1,563	2,959	2,789	2,644
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës	561	494	612	693	737

18	Shtypja dhe riprodhimi i mediave të incizuara	210	308	649	752	579
19	Prodhimi i Koksit dhe produkteve të rafinuara të naftës	166	507	340	422	218
20	Prodhimi i produkteve kimike	95	602	605	592	775
21	Prodhimi i produkteve bazë farmaceutike dhe preparateve farmaceutike	-	66	249	334	398
22	Prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës	3,040	3,257	3,922	3,138	1,434
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	2,634	3,333	5,052	4,970	3,581
24	Prodhimi i Metaleve	942	1,248	1,766	1,616	1,834
25	Prodhimi i produkteve të fabrikuara metalike	2,473	2,966	3,092	3,232	4,929
26	Prodhimi i kompjuterëve, produkteve elektronike dhe optike	20	81	565	326	17
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	168	805	2,087	472	420
28	Prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t.	22	111	110	50	195
29	Prodhimi i mjeteve motorike, rimorkio dhe gjysmë rimorkio	115	23	68	-	92
30	Prodhimi i mjeteve tjera të transportit	-	-	201	65	48
31	Prodhimi i mobileve	4,774	4,730	4,593	3,695	4,719
32	Prodhimi tjetër p.k.t.	5,949	2,405	1,810	964	690
33	Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve	7,677	2,349	2,227	3,227	3,089
	Gjithsej	47,454	35,870	43,668	41,485	40,034

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Sa i përket nën sektorëve, numri me i madh i të punësuarve në pese vitet e fundit prin nën sektorin e “Përpunimi i produkteve ushqimore” ku në vitin 2021 ka 8,017 të punësuar apo 20%.

Nën sektori “Prodhimi i produkteve të fabrikuara metalike” ka 4,929 të punësuar apo 12%, vendin e tretë radhitet nën sektori “Prodhimi i mobileve” me 4,719 të punësuar apo 11.7%, vendin e katër zë “Prodhimi i produkteve minerale jo metalike” me 3,581 të punësuar apo 9%.

Informaliteti i punësimit në sektorin C

Në tabelën nr. 4, janë krahasuar të dhënat e punësimit sipas ATK-së me të dhënat e punësimit sipas anketës. Sipas këtyre të dhënave, rezulton se në pesë vitet e fundit vërehet rënie e informalitetit në punësim sipas sektorit C.

Nga gjithsej 24 nënsektorët e sektorit C, 12 nga nënsektorët e paraqitur në tabelën 4 kanë informalitet i cili mundë të trajtohet nga institucionet përkatëse.

Tabela 4. Identifikimi i nënsektorëve me informalitet më të lartë

Nr.	Nën sektorët e identifikuar me informalitet më të lartë (krahasimi mes tabelës 2, punësimit të regjistruar dhe tabelës 3, sipas anketës se fuqisë punëtorë)	Shtrirja e nën sektorëve sipas përqindjes së numrit të ndërmarrjeve të regjistruara në bazë të regjioneve (Tabela 1)
1	Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve	Te ky nën sektor, 41% të ndërmarrjeve operojnë në regjionin e Prishtinës.
2	Prodhimi i produkteve bazë farmaceutike dhe preparateve farmaceutike	Te ky nën sektor, 37.50% të ndërmarrjeve operojnë në regjionin e Ferizajt dhe 25% në regjionin e Prishtinës.
3	Prodhimi i Metaleve	Te ky nën sektor, 28.91% të ndërmarrjeve operojnë në regjionin e Prishtinës
4	Prodhimi tjetër p.k.t.	Te ky nën sektor, 33.96% të ndërmarrjeve operojnë në regjionin e Prishtinë, 21.7% në regjionin e Pejës.
5	Prodhimi i pajisjeve elektrike	Te ky nën sektor, 34.09% të ndërmarrjeve operojnë në regjionin e Prishtine, 20.45 Gjakove
6	Prodhimi i produkteve të fabrikua metalike	Te ky nën sektor, 25.71% të ndërmarrjeve operojnë në regjionin e Prishtinës.
7	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	Te ky nën sektor, 33.33% të ndërmarrjeve operojnë në regjionin e Prizrenit, 28.21% në regjionin e Prishtinës.
8	Prodhimi i veshjeve	Te ky nën sektor, të ndërmarrjeve operojnë në regjionin e 25.43% të ndërmarrjeve operojnë në regjionin e Prishtinës, 22.29% në regjionin e Gjakovës
9	Prodhimi i tekstilit	Te ky nën sektor, 30.64% të ndërmarrjeve operojnë në regjionin e Prishtinës, 18.50% në regjionin e Ferizajt

10	Prodhimi i Koksit dhe produkteve të rafinuara të naftës	Te ky nën sektor, 37.5% të ndërmarrjeve operojnë në regjionin e Ferizaj, 25% në regjionin e Prishtinës
11	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës	Te ky nën sektor, 40.2% të ndërmarrjeve operojnë në regjionin e Prishtine, 20.59% në regjionin e Prizrenit.
12	Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës	Te ky nën sektor, shpërndarja e ndërmarrjeve është po thuaj se e njëjtë në të gjithë regjionet.

Duke u bazuar në tabelën 4, pasqyrohet se nën sektori me më shumë informalitet në punësim është “Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve” pastaj radhitet “Prodhimi i produkteve bazë farmaceutike dhe preparateve farmaceutike”, Prodhimi i Metaleve etj.

Në tabelën 4, është pasqyruar edhe Shtrirja e nën sektorëve sipas përqindjes së numrit të ndërmarrjeve të regjistruara në bazë të regjioneve dhe jo përqindjen e bizneseve informale.

Përqindja e ndërmarrjeve të regjistruara e shpërndarë në regjione, orienton identifikimin e informalitetit më të lartë të punësimit për nën sektorët e prezantuar në tabelë.

Konkluzionet:

- Informaliteti në punësim sipas sektorit C, është më i lartë se nën sektorët të cilët janë të përqendruar ndërmarrjet mikro;
- Informaliteti në punësim është më i lartë se ndërmarrjet që merren me artizanale dhe ku niveli i arsimimit është më i ulët krahasuar me nën sektorët tjerë.